

VENDIM
Nr. 126, datë 29.10.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HP UJANIKU ENERGY”, SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “UJANIK 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 2.5 MW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 1, pika 1, germa “a” e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HP Ujaniku Energy”, sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Ujanik 2”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HP Ujaniku Energy”, sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në rregulloren, “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4, 4.1.5).

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.3), (Paraqitja e përgjithshme skematike e centralit, diagrami elektrik i agregateve dhe bllokut të transformimit, si dhe shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet centrali.), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores, “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pikat 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “HP Ujaniku Energy”, sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ujaniku 2”, me fuqi të instaluar 2.5 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti